

**NI. THE DOOR**

Në Shërbim të Komunitetit të Shkodrës

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR**Nr. 3814/49 Prot  
Shkodër, më 23.06.2020Nr. \_\_\_\_\_ Prot  
Shkodër, më 23.06.2020**K O N T R A T Ë S H È R B I M I**

“Shkodra e traditës &amp; kulturës”

Sot, më datë \_\_\_/\_\_\_/2020, në Shkodër lidhet kjo kontratë shërbimi ndërmjet:

**BASHKISË SHKODËR** me adresë Rr. “13 Dhjetori”, Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI, në cilësinë e titullarit të Institucionit, në vijim referuar edhe si “**Bashkia**”;

dhe

**SHOQATA The Door**, me seli në rrugën Bujar Bishanaku, Nr 799, Shkodër, përfaqësuar nga z. Kastriot Faci me nr NIPT K46823026U, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv të shoqatës, në vijim referuar edhe si “**Shoqata**”

Bashkia dhe Subjekti fitues do të referohen në vijim edhe si “Pala” ose “Palët”.

Duke qënë se Palët:

*Vlerësojnë* rëndësinë e promovimit të territorit dhe zhvillimin e turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër.


*Marrin në konsideratë* politikat zhvillimore të Bashkisë Shkodër në drejtim të organizimit të aktiviteteve që synojnë promovimin e elementeve të trashëgimisë kulturore që favorizojnë zhvillimin e turizmit në territorin e saj.

*Synojnë* realizimin objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

*Njohin* eksperiencën e The Door në promovimin e potencialeve turistike dhe në promovimin e vlerave më të mira të kulturës dhe qytetarisë shkodrane.

*Konfirmojnë* angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim të projektit “Shkodra e traditës & kulturës”.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



## Neni 1 Baza Ligjore


- a. Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994 me ndryshimet përkatëse, neni 463, pjesa V-të, "Kontratat" titulli I-rë (kreu I-rë deri tek kreu III-të), titulli II-të.
- b. Ligji 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 25.
- c. VKB nr. 43 datë 19.06.2018 "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë 01.06.2016 Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër" është ngritur dhe funksionon Këshilli Artistiko-Kulturor i Bashkisë Shkodër.
- d. VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për "Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër" si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile",
- e. VKB nr. 26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër".

Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë si më poshtë vijon:

## Neni 2 Përkufizime

Termet e përdorura në këtë kontratë, kanë kuptimin e mëposhtëm:

- 2.1 Kontratë**, nënkupton marrëveshjen e shkruar, e lidhur midis Bashkisë dhe Subjektit fitues.
- 2.2 Palë (ët)**, nënkupton Bashkinë dhe Subjektin fitues vec e vec ose të referuar sëbashku në këtë kontratë.
- 2.3 Subjekti fitues**, nënkupton shoqatën e cili do të ofrojë shërbimin sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.
- 2.4 Projekt Propozimi**, nënkupton përshkrimin e detajuar të një serie aktivitetesh, që synojnë zgjidhjen e një problemi të caktuar.
- 2.5 Buxheti**, nënkupton shprehjen e projektit në vlera monetare.
- 2.6 Plani i aktivitetit**, nënkupton shtrirjen e aktiviteteve në një periudhë të caktuar kohore.
- 2.7 Tabela indikatorëve**, nënkupton përshkrimin e detajuar të indikatorëve mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i performancës.
- 2.8 Udhëzuesi për zbatimin e projekteve**, nënkupton udhëzimet për menaxhimin administrative dhe financiar të projektit.
- 2.9 Raport monitorimi**, nënkupton analizimin e informacionit dhe mbikqyrjen e zbatimit të projektit.
- 2.10 Raport përfundimtar**, nënkupton përmbledhjen e dinamikës (veprimtaritë/financat) së zbatimit të projektit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në datën e realizimit të aktivitetit.



**Neni 3**  
**Qellimi i Kontratës**

Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës The Door për zbatimin e projektit “Shkodra e traditës & kulturës”, e cila synon që nëpërmjet aktiviteteve social-kulturore dhe argëtuese të influencojë në promovimin e potencialeve ekonomike, turistike dhe argëtuese të Bashkisë Shkodër.

**Neni 4**  
**Objekti i Kontratës**

Të organizojë festën e celjes së sezonit turistik 2020, për promovimin e vlerave natyrore turistike dhe turizmin në plazhin e Velipojës.

Të organizojë një aktivitet argëtues-garues për promovimin e bicikletës, “simbolit” të qytetit tonë, me pjesëmarrjen e 100 të rinj dhe të rritur nga Bashkia Shkodër si dhe jashtë vendit, gjatë 3 mujorit të dytë të projektit.



Të organizojë Lojra popullore fest edicioni i 13-të, një aktivitet social-kulturor për promovimin e traditave tona kulturore në nxitjen e zhvillimit të turizmit kulturor në qytetin e Shkodrës, me pjesëmarrës 100 fëmijë e të rinj nga Bashkia Shkodër si dhe në rang Qarku, të rinj nga vende të tjera, brenda 3 mujorit të fundit të projektit.

**Neni 5**  
**Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë**

- 5.1 Përcakton kriteret e nevojshme dhe specifikimet për zbatimin e projektit, si dhe miraton kalendarin e aktiviteteve.
- 5.2 Harton raportin e monitorimit për shërbimin e kryer nga subjekti fitues në përputhje me specifikimet e përcaktuara në projekt dhe udhësuesit për zbatimin e projekteve.
- 5.3 Bashkia Shkodër ka të drejtën për të mos e kaluar fondin në dispozicion nëse nuk janë përmbushur indikatorët e përcaktuar në kontratë.
- 5.4 Siguron dhe vendos në dispozicion të Subjektit fituesin informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e zbatimit të projektit.
- 5.5 Siguron kushtet e përshtatshme mjedisore për zhvillimin e aktiviteteve.
- 5.6 Në rastet e forcës madhore, Bashkia mund të kërkojë në çdo kohë rishikimin ose pezullimin e aktiviteteve të projektit.

**Neni 6**  
**Të drejtat dhe detyrimet e Subjektit fitues**

- 6.1 Zhvillon aktivitetet e përshkruara në planin e aktiviteteve dhe buxhetin bashkangjitur kësaj kontrate me kujdesin dhe qllësinë e duhur.




- 6.2 Siguron zbatimin e projektit sipas Udhëzuesit për zbatimin e projektit, në kuadër të Programit ReLOaD.
- 6.3 Harton dhe dorëzon raportet mbi dinamikën (veprimtaritë / financat) e zbatimit të projektit duke shfrytëzuar formatin e raportimit që gjendennë Udhëzuesin për Zbatimin e projektit.
- 6.4 Informon Bashkinë për çdo vështirësi të identifikuar gjatë zbatimit të projektit.
- 6.5 Subjekti fitues duhet të mbajë të dhëna të qarta, të sakta dhe të plota në lidhje me shpenzimet e realizuara sipas kësaj Kontrate.
- 6.6 Subjekti fitues do të sigurojë, përpilojë dhe vë në dispozicion në çdo kohë Partnerit Zbatues, Bashkisë Shkodër çdo regjistrim ose informacion, me gojë ose me shkrim, që Bashkia mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve.
- 6.7 Siguron pjesëmarrjen e gjerë në aktivitete.
- 6.8 Në rastet e forcës madhore si dhe sipas kërkesës/autorizimit të Bashkisë, subjekti fitues zhvillon aktivitetet sipas kërkesës së bashkisë, në zbatim të vendimeve që dalin për ngjarjet e forcës madhore.

#### **Neni 7 Afati i Kontratës**

Kontrata do të realizohet brenda 5 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës. Ajo mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, me dakordësinë e palëve, duke përcaktuar një datë të re përfundimi.

#### **Neni 8 Vlefë e Kontratës**

- 8.1 Kontrata lidhet për vlerën 1,100,000 lekë pa tvsh. Shoqata nuk është subjekt i tvsh-së.
- 8.2 Financimi realizohet nga Buxheti 2020 i Bashkisë Shkodër.
- 8.3 Vlera financiare e kontratës duhet të depozitohet në llogarinë bankare të Shoqatës The Door, të cilat detajet janë si më poshtë:
- Emri i llogarisë:** The Door
- Emri i bankës:** ProCredit Bank Albania
- IBAN:** AL89209516090000600096330301
- 8.4 Bashkia e Shkodrës do të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës, sipas realizimit të planit të aktiviteteve të përcaktuar në projekt, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshje nga fondi i parashikuar në buxhetin e vitit 2020 të Bashkisë Shkodër.
- 8.5 Levrimi i shumës do të bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit mbështetës dhe verifikimit të tij nga Bashkia Shkodër përpara, aktivitete, dukshmëri, sipas Udhëzuesit për zbatimin e projekteve për periudhën kohore nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje deri në përfundim të saj.
- 8.6 Fondi i miratuar për këtë qëllim është në zbatim të Thirrjes së tretë për organizatat e shoqërisë civile në Bashkinë Shkodër, Programi Reload.



8.7 Fondi i miratuar për këtë qellim është në zbatim të Thirrjes së tretë për organizatat e shoqërisë civile në Bashkinë Shkodër, Programi Reload.

**Neni 9**  
**Ndalimi i Nënkontraktimit**

Subjekti fitues për zbatimin e projektit për të cilën është shpallur fitues nuk i lejohet të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë.

**Neni 10**  
**Prona Intelektuale**

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Subjekti fitues gjatë kontratës do ti përkasin Bashkisë, i cili mund ti përdorë ato sipas gjykimit të tij.

**Neni 11**  
**Gjuha e Kontratës**

Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

**Neni 12**  
**Vendndodhja**



Aktivitetet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë Shkodër, siç janë përcaktuar në projekt.

**Neni 13**  
**Përcaktimi i ngjarjeve të forcës madhore**

Për efekt të zbatimit të kësaj Kontrate forcë madhore do të quhen:

- a. Fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të pritëshin që të ndodhnin; kushtet jashtëzakonisht të këqija të motit, rrufetë, tërmetet, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret apo dhe rrëshqitjet e tokës.
- b. Një akt lufte (qoftë i shpallur apo i pashpallur), pushtim, konflikt i armatosur apo akt i armikut të huaj, bllokadë, embargo, trazira, kryengritje, veprime terroriste ose ushtarake, çrregullime civile ose sabotime të motivuara politikisht, që tejkalojnë një periudhë që zgjat më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

**Neni 14**  
**Zgjidhja e Kontratës në rast të forcës madhore**



14.1 Nëse një ngjarje e forcës madhore vijon apo, sipas gjykimit të arsyeshëm të Palëve, ka të ngjarë të vijojë përtej një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh, Palët mund të vendosin ta zgjidhin këtë Kontratë ose ta vijojnë zbatimin e kësaj kontrate, mbi bazën e kushteve të reja të rëna dakord reciprokisht.

14.2 Nëse Palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje në lidhje me këtë, Pala e prekur, pas kalimit të periudhës së përmendur prej 30 (tridhjetë) ditësh, do të ketë të drejtën ta zgjidhë këtë kontratë duke lëshuar një njoftim zgjidhjeje.

## **Neni 15** **Njoftimet e Palëve**

15.1 Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim. Njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kontratës.

15.2 Njoftimet duhet të përmbajnë, por nuk kufizohen, tek të dhënat si më poshtë:

- detajet e duhura në lidhje me shkakun e mospërmbushjes dhe të zgjidhjes;
- afatin për korrigjimin e ngjarjes së mospërmbushjes si dhe veprimet/masat, që pasojnë mosrespektimin e afatit, sipas përcaktimeve në këtë kontratë;
- çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

15.3 Adresat dhe numrat e kontaktit, që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, janë:

Për Bashkinë

Voltana Ademi Kryetari i Bashkisë:

Adresa: Rr. "13 Dhjetori", nr. 1, Shkodër,

E – mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Për Subjektin fitues "The Door"

Adresa: L. Naim Gjylbegu, Rr. Bujar Bishanaku, Nr 799, Shkodër, Shqipëri

Tel: 06820206559 E-mail: [thedoort@infothedoort.com](mailto:thedoort@infothedoort.com)



## **Neni 16** **Mosmarrëveshjet**

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përipiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ato i drejtohen zgjidhjes së kontratës duke respektuar procedurat juridike sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 17** **Rishikimi i Kontratës**

Palët ruajnë të drejtën e rishikimit të Kontratës, në rastet kur Bashkia e vlerëson të nevojshme të kryhen ndryshime thelbësore në këtë Kontratë.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



**Neni 18**  
**Dispozita të fundit**

18.1 Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate është plani i aktiviteteve, buxheti dhe plani i indikatorëve bashkëngjitur kësaj kontrate.

18.2 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

18.3 Kjo kontratë u hartua në 4 kopje nga të cilat një të merr Subjekti fitues ndërsa tre të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

**PËR BASHKINË SHKODËR**

**Kryetar**

**Voltana Ademi**




**PËR SHOQATEN**

**Drejtor Ekzekutiv**



**Kastriot Faci**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "K. Faci", is written over the name.



A. PLANI I AKTIVITETEVE

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5
Rezultati i pritshëm 1					
<b>Aktiviteti 1.1</b>	Hapja e sezonit turistik të Velipojës				
1.2 Identifikimi i grupit të bashkëpunëtorëve/ pjesëmarrës					
1.3 Realizimi eventit 1					
1.4 Raportimi					
1.5 Aktivitete dukshmërie					
Rezultati i pritshëm 2					
<b>Aktiviteti 2.1</b>			Dita e bicikletave		
2.2 Identifikimi i grupit të bashkëpunëtorëve/ pjesëmarrës					
2.3 Realizimi eventit 2					
2.4 Raportimi					
2.5 Aktivitete dukshmërie					
Rezultati i pritshëm 3					
<b>Aktiviteti 3.1</b>				Lojra popullore fest	
3.2 Identifikimi i grupit të bashkëpunëtorëve/ pjesëmarrës					
3.3 Realizimi eventit 3					
3.4 Raportimi					
3.5 Aktivitete dukshmërie					




*Handwritten signature*



B. OSHC OBJEKTIVAT E PËRFORMANCËS

Objektivat e përfomancës	Baza	Kohëzgjatja	
		Propozuar	Aktuale
Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete promovuese të zhvillimit të turizmit dhe argëtimit, me fokus traditën shkodrane	<p>Shkodra është një qytet me kulturë e tradita të lashta, komponentë të cilët kanë patur dhe kanë një influencë mjaft të mira për zhvillimin e ekonomisë dhe të turizmit.</p> <p>Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete të tilla me karakter folklorik synon përcjelljen e ketyre traditave veçanërisht të brezat e rinj.</p> <p>Ndërkohë, referuar “Planit të veprimit për rininë 2015-2020” shikohet një mungesë e përfshirjes së të rinjve në aktivitete kulturore dhe argëtuese.</p>	<p><b>Hapja e sezonit turistik të Velipojës</b> Përformim i një grupi muzikor Numra të ndryshëm argëtues Lojra sportive në rërë nga ekipet sportive si dhe qytetarë të rastit. 1 shërbim televiziv 30 Kapele dhe buza</p> <p><b>Dita e bicikletave</b> Aktivitet argëtues-garues për promovimin e bicikletës, “simbolit” të qytetit tonë, me pjesëmarrjen e 100 të rinjve dhe të rriturve nga Bashkia Shkodër. 1 shërbim televiziv 50 Kapele dhe buza</p> <p><b>Lojra popullore Fest</b> Aktivitet social-kulturor për promovimin e traditave tona kulturore me pjesëmarrjen e 100 fëmijë e të rinj nga Bashkia Shkodër/Bashki të tjera brenda dhe jashtë vendit. 1 shërbim televiziv 15 Kapele dhe buza</p>	



SHTOJICA 8. BUXHETI I NDARË SIPAS ZËRAVE

Emri i Organizatës The Door

Titulli i Projektit Shkrota e traditës & kulturës

Buxheti

Rezultati sipas Kërkesës Logjike	Nr	Kategori	Lloji i Njësive	Muaji	Kosot për njësi (Lekë)	Totali (Lekë)
1.	STAFI					201,000
1.1.	Drejues projekt		muaj	3	27,000	81,000
1.2.	Asistent projekt		muaj	3	20,000	60,000
1.2.	Financiar projekt		muaj	3	20,000	60,000
2.	SHPENZIME TRANSPORTI					0
2.1						
2.2						
2.3						
3.	SHPENZIMET E PROJEKTI					832,004
3.1.	Administratë i "Pastra e Vellojes"					367,004
3.1.0	Sherbime transporti të përgjithshme		pasagjer	120	600	72,000
3.1.1	Sherbime transporti të natyrale		rugë	3	10,000	30,000
3.1.2	Shërbime dhe fletë		shërbime fletë	1	100,000	100,000
3.1.3	Refreshments		event	1	50,004	50,004
3.1.4	Qera ndërvendore		copë	10	1,000	10,000
3.1.5	Blenda muzikore		blende	1	60,000	60,000
3.1.8	Sherbime televizione aktiviteti i (filmin dhe montazhi) në TV lokal		filmin/montazhi	1	30,000	30,000
3.1.7	Stampim kopje dhe blaza aktiv.1		copë	30	500	15,000
3.2.	Administratë 2 "Dita e Bëllëzimeve"					250,000
3.2.1	Pastim dhe sistemim ditë		pasir	1	12,000	12,000
3.2.2	Akomodim dhe ushqim për të ftuarit nga larg.		pers	30	2,000	60,000
3.2.3	Kohëcil		pers	150	300	45,000
3.2.4	Kamsheri		copë	1	3,000	3,000
3.2.5	Telëfonat			1	5,000	5,000
3.2.6	Shërbime dhe fletë		shërbime fletë	1	60,000	60,000
3.2.7	Sherbime televizione aktiviteti i (filmin dhe montazhi) në TV lokal					30,000
3.2.8	Stampim kopje dhe blaza aktiv.2		copë	50	700	35,000
3.3.	Administratë 3 "Jeta Popullore Fëmijë"					215,000
3.3.1	Honorare për detyrimet e trajtimit		trupa	7	5,000	35,000
3.3.2	Moderatore, lektor		pers	2	7,000	14,000
3.3.3	Juris honorare		pers	3	6,000	18,000
3.3.4	Artizane honorar		pers	0	0	0
3.3.5	Sherbime transporti për muajt		trupa	3	5,000	15,000
3.3.6	Sherbime transporti për materialin		rugë	2	5,000	10,000

Muaj 1	Muaj 2	Muaj 3	Muaj 4	Muaj 5	Muaj 6	Muaj 7	Muaj 8	Muaj 9
87,000	0	0	87,000	87,000	0	0	0	0
27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	0	0	0	0
20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	0	0	0	0
20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0
367,004	0	0	250,000	215,000	0	0	0	0
367,004	0	0	0	0	0	0	0	0
72,000								
30,000								
100,000								
50,004								
10,000								
60,000								
30,000.00								
15,000.00								
0	0	0	260,000	0	0	0	0	0
			12,000.00					
			60,000.00					
			45,000.00					
			3,000.00					
			5,000.00					
			60,000.00					
			30,000.00					
			35,000.00					
0	0	0	0	215,000	0	0	0	0
				35,000.00				
				14,000.00				
				18,000.00				
				0.00				
				15,000.00				
				10,000.00				



Effect



3.3.7	Ferri	1	40,000	40,000			40,000.00							
3.3.8	Qena kostumave imajinacionale	cope	10	1,500	15,500		15,500.00							
3.3.9	Akonordim dhe ushqim për të rinjtë nga larg	perce	35	1,000	35,000		35,000.00							
3.3.10	Sisteme televizive aktiviteti 'ngjithine me firm' (firmën dhe montazhin) në TV lokal				25,000		25,000.00							
3.3.11	Stipendia baze aktiv-3	cope	15	500	7,500		7,500.00							
4	<b>DUKSHIVERIA</b>						15,996.00	0	0.00	33,000.00	0	0.00	6.00	0.00
Aktiv 1	4.1						10,500.00							
4.2	Prodhim Baze për aktivitetin 1	m1	7	1,500	10,500									
4.3	Diploma aktiv-1	cope	15	100	1,500		1,500.00							
4.4	Trefe aktiv-1	cope	3	1,332	3,996		3,996							
Aktiv 2	4.2													
4.5	Prodhim Baze për aktivitetin 2	m1	5	4,000	20,000			20,000.00						
4.6	Diploma aktiv-2	cope	20	150	3,000			3,000.00						
4.7	Trefe aktiv-2	cope	5	2,000	10,000			10,000.00						
Aktiv 3	4.13													
4.14	Prodhim Baze për aktivitetin 3	m1	5	3,000	15,000			15,000.00						
4.15	Diploma aktiv-3	cope	20	150	3,000			3,000.00						
4.17					0									
							18%							
							82%							
	<b>Totali i kostove Administrative (1-7)</b>						450,000.00	0.00	0.00	950,000.00	9.00	0.00	0.00	0.00
	<b>Totali i Kostove IB Projektit (2+4)</b>													
	<b>TOTAL HUNJETHI (KOSTOVAR) 1-15-16</b>													
BASIKEPINANCIMI (1-4-8)														
<b>BUXHETI TOTAL (1-16)</b>														

Shprehime

**WHITE DOOR**  
ALBANIA

*Shprehime*

